

S T A T U T  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"NDËRTIM-BS" SH.P.K.

**S T A T U T**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Ndërtim-BS” SH.P.K**

**KREU I**

**Dispozita te Pergjithshme**

*Neni 1*

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ndërtim-BS” Sh.p.k do të funksionojë sipas këtij Statuti të përpiluar dhe nënshkruar nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, bazuar në Ligjin Nr.9901, date 14/04/2008.

*Neni 2*

Emertimi i shoqerise eshte “Ndërtim-BS” Sh.p.k.

*Neni 3*

Shoqëria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesit te saj.

*Neni 4*

Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar “Ndërtim-BS” Sh.p.k ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie dhe me legjislacionin shqiptar, rregullon poziten juridike te themeluesit dhe te punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe çeshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

*Neni 5*

Shoqëria “Ndërtim-BS” Sh.p.k eshte person juridik shqiptar, dhe fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit ne organet perkatese.

Shoqëria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj, aktin e themelimit dhe ne kete statut.

*Neni 6*

Selia e Shoqerise “Ndërtim-BS” Sh.p.k eshte ne **“Lagja Sporti, Pallati 37, Apartamenti 9” Gramsh**

*Neni 7*

Administrator i shoqerise eshte z. Sabri IBRAHIMI.

*Neni 8*

Shoqëria ka vulen e saj me permbajtjen : **Shoqëria me Pergjegjesi te Kufizuar “Ndërtim-BS” Sh.p.k Gramsh**

*Neni 9*

Shoqëria “Ndërtim-BS” Sh.p.k, ka per objekt te veprimtarise ekonomike :



- Ndërtim objektesh dhe kompleksesh të ndryshme banimi, konstruksion dhe punime restaurimi, të objekteve civile, industriale, tregëtare, turistike, shëndetësore, kulturore, sportive, vepra kullimi dhe vaditje, infrastrukturë, shërbime komunale, projektim i objekteve të treguara më sipër
- Ndërtim e riparime rrugësh, punime e mirëmbajtje të traseve hekurudhore, ndërtim e vepra arti rrugore e hekurudhore, ndërtim e riparime ujësjellesash e kanalizimesh, ndërtim e riparime objektesh portuale.
- Ndërtim Hidrocentrale dhe Termocentrale të kapacitetit të vogel dhe mesatar.
- Prodhim inertesh, gelqere, çimento, beton, asfalt, e materiale të ndryshme ndërtimi, nëpërmjet ngritjes së linjave të prodhimit, gurorëve, nyjeve të betonit, dhe nyjeve asfalt prodhuese, dhe tregëtimin e tyre me shumicë e pakicë.
- Shfrytëzim të gurit gëlqeror.
- Asistencë dhe ekspertizë teknike, supervizion, kolaudim.
- Prodhim, montim dhe tregëti me shumicë e pakicë i paneleve për prodhimin e energjisë diellore, dhe aksesorëve të tyre nëpërmjet ngritjes së linjave të prodhimit dhe montimit, si dhe shpërndarja e tyre brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë
- Veprimtari minerare, që lidhen me kërkimin, zbulimin, zhvillimin, shfrytëzimin, përpunimin, tregëtimin e produkteve minerare, si dhe kujdesin, mirëmbajtjen, monitorimin, ose mbylljen e minierave, duke pasur parasysh edhe rehabilitimin e mjedisit.
- Puse-shpime gjeologo inxhinierike, shpime për ujë etj.
- Instalime për nenstacionet-kabinat e transformatorëve-linjat e Tensionit të Lartë e të Mesëm.
- Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike të Tensionit të Ulët, linjave për telefoni, radiotelefoni, televizive, citofoni-mirëmbajtja e tyre
- Studime/Vlerësime gjeologo inxhinierike të truallit për objekte civile-ekonomike
- Studime/Vlerësime gjeologo inxhinierike të truallit për objekte të mëdha H/C, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.
- Studime/Vlerësime gjeologo inxhinierike të trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- Studime e projektme hidrogjeologjike
- Studime dhe projektme karierash.
- Blerje, shitje, qera, vlerësim, etj, e trojeve, ndërtesave, dhe pasurive të paluajtshme në çfarëdo forme që të jenë, nëpërmjet ngritjes së agjensive imobiliare.
- Prodhim dhe përpunim lënde drusore dhe mobilje, si dhe tregëti me shumicë e pakicë import-eksport mobilje të të gjitha llojeve si dhe lëndëve të para për prodhimin e mobiljeve, makinerive për prodhimin dhe përpunimin e lëndës drusore si dhe pjesë këmbimi për to.
- Tregëti e artikujve për higjienën e trupit, e artikujve të kozmetikës, dentare, optike, higjieno - sanitare dhe paisje e vegla mjekësore të shërbimit human e veterinar, me shumicë e pakicë import-eksport.
- Tregëti me shumicë e pakicë import-eksport, e mallrave ushqimore, industriale, bujqësorë blegtorale, elektroshtëpiake, konfeksione.
- Transport urban dhe interurban, brenda dhe jashtë vendit. Transport rrugor, detar dhe ajror, mallrash dhe pasagjerësh, për nevoja të shoqërisë dhe të tretëve.
- Agjensi spedicioni.
- Servis automjetesh.



- ◆ Tregëti me shumicë e pakicë, import – eksport i mjeteve të mekanizuara, makineri transporti, automjete të ndryshme, e ndërtimi, mineraleve, elektrike e hidrosanitare, impjanteve teknologjike dhe ngrohje ventilimit.
- ◆ Tregëti nëpërmjet hapjes së minimarketeve, bare dhe restorante, ushqim social.
- ◆ Tregtimi me pakicë i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si benzol, gazoil, vajguri ndricues, vajra lubrifikante, solar, mazut, bitum, propan, butan, ksilol, etj.
- ◆ Importimi – eksportimi dhe ndërtimi i makinerive dhe paisjeve që shërbejnë për depozitimin, ambllazhimin, transportimin, tregëtimin dhe përdorimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
- ◆ Përgatitje studimesh dhe projektesh, si dhe dhënie asistence teknike për disenjimin dhe ndërtimin e objekteve dhe impianteve që shërbejnë për depozitimin, ambllazhimin, transportimin, tregëtimin dhe përdorimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
- ◆ Hapja e linjave të prodhimit me material të porositur si dhe me materiale të tjera të siguruar brenda dhe jashtë vendit.
- ◆ Aktivitet në rritjen dhe shtimin e peshkut, tregëtim i tij me shumicë e pakicë, mbledhja, import-eksporti i vezëve të peshkut dhe kultivim rasati si dhe blerja e tij nga ndërmarrje a individë të tjerë brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
- ◆ Mbarështrim të gjësë së gjallë të llojeve të ndryshme, me shumicë e pakicë.

#### *Neni 10*

Shoqeria ushtron veprimtarine e vet te percaktuar ne kete statut ne territorin e Republikes se Shqiperise. Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te çele dege, zyra dhe filiale te saj te perfaqesimit brenda dhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku eshte hapur.

#### *Neni 11*

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

#### *Neni 12*

Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon ortakun te kete pavaresi ligjore, per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

Ai nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tek kapitali themelor ku ai ka marre pjese.

#### *Neni 13*

Ortaku ka keto te drejta kryesore :

- Te marre pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise, ne perputhje me kontraten dhe statutin vete ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
- Te marre pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne cdo forme dhe sasi qofte ne perputhje me statutin dhe kontraten.
- Te marre pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen, nepermjet perfaqesuesit te tij ose vete.
- Te kerkoje ti jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen tregtare te shoqerise si dhe te gjitha dokumentet e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.



- Te beje propozime dhe ti paraqese ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeruje dhe shkarkoje perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.
- Te heqe dore nga shoqeria. Heqja dore nga shoqeria nuk liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.

*Neni 14*

Ortaku ka keto detyra kryesore :

- Te marre pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tij, vete ose nepermjet perfaqesuesve qe krijon ai.
- Ti jape shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

**KREU II**  
**Kushtet ekonomike**

*Neni 15*

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te veprimtarise kontabel dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

*Neni 16*

Kapitali themeltar i shoqerise është 100.000 (njqind mije) Leke, i perbere nga 1 kuote, me vlerë nominale 100.000 (njqindmije) Lekë e shlyer dhe e nenshkruar teresisht nga ortakun i vetem

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi ne para i Ortakut te vetem.

*Neni 17*

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te saj ortakun ka te drejten e rritjes se tij ne menyre proporcionale.

*Neni 18*

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve dhe paraardhesve e pasardhesve.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

*Neni 19*

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

*Neni 20*





Shoqëria krijon fonde rezerve ose dhe fonde të tjera të veçanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

Shoqëria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj, mbulohen nga fondet rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare që kur dëshirojnë mund të derdhen prej ortakut, në rastet kur këto detyrime nuk mund të mbulohen nga fondet ekzistuese.

### **KREU III**

#### **Viti financiar, llogarite vjetore, ndarja e fitimit.**

##### *Neni 21*

Çdo vit financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

##### *Neni 22*

Llogarite vjetore, inventari, raportet, operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga ortakut i vetëm. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

##### *Neni 23*

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si dhe fondet e lena rezerve për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamen tregetare etj, e perfiton ortakut i vetëm i kesaj shoqërie.

##### *Neni 24*

Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 marsit të vitit pasardhës.

### **KREU IV**

#### **Administrimi**

##### *Neni 25*

Ortakut i perballon humbjet deri në kufirin e vlerës së tij të derdhur në formën e kapitalit themeltar.

##### *Neni 26*

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Pergjithshme. Mbledhja e Asamblese së Pergjithshme mund të thirret nga Administratori, eksperti kontabel i autorizuar ose likuiduesi.

##### *Neni 27*

#### **KUORUMI**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e pergjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave. Në rastin kur asambleja e



pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 te ligjit Ligjit Nr.9901, date 14/04/2008 ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te 3 te nenit 88 te ligjit Ligjit Nr.9901, date 14/04/2008. Nese Asambleja e Pergjithshme, nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### **MARRJA E VENDIMEVE.**

Me perjashtim te rasteve kur statuti parashikon nje shumice me te larte, asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votive te ortakeve pjesemarres, siç percaktohet ne piken 1, te nenit 86 te Ligjit Nr.9901, date 14/04/2008, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe, ne ligj ose ne statut per çeshtjet e tjera te renditura ne nenit 81 te Ligjit Nr.9901, date 14/04/2008, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj vlefshmeria e vendimeve, qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, te parashikuara ne ligj ose ne statut, kushtezohet nga miratimi i ortakut pjesemarres.

#### *Neni 28*

Administrimi i shoqerise behet nga Administratori. Me miratimin e Ortakut te Vetem te shoqerise, zoti Sabri IBRAHIMI emerohet administrator dhe perfaqesues i Shoqerise "Ndërtim-BS" Sh.p.k, per nje periudhe pese vjeçare me te drejte rizgjedhje. Administratori ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e saj.

#### *Neni 29*

Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektivin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkeljet e ligjeve, te statutit, apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

#### *Neni 30*

Kompetencat e administratorit ne shoqeri jane :

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te beje propozimet e nevojshme ne mbledhjet e asamblese, kur lind nevoja e ndryshimit te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te miratoje aktet normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijojte organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektiveve te shoqerise.
- Te propozoje ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme per krijimin e njesive, strukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatise propozimin per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqese ato asamblese per miratim.



- Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likuidimit dhe te paraqese propozimet per miratim ne asamble.
- Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te asamblese.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

*Neni 31*

Kontrolli i shoqerise mund te kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhje. Ai caktohet nga administratori i shoqerise. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ose kur behet e pamundur kryerja e detyreve.

**KREU V**

**Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise.**

*Neni 32*

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet mbi dhjete vjet.

**KREU VI**

**Marredheniet e punes**

*Neni 33*

Mareveshja e punes ne shoqeri rregullohet ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionin shqiptar dhe me kete statut.

*Neni 34*

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet ne baze te kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto çeshtje :

- Kushtet dhe menyra e marredhenieve ne pune.
- Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tyre ne vendin e punes.
- Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes.
- Puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.
- Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.
- Pushimet dhe mungesat.
- Te drejtat detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.
- Paga e punes se punonjesve, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

*Neni 35*

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj, ne organet perkatese, duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

*Neni 36*





Per te gjitha mosmarreveshjet, qe mund te lindin, gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Gramsh.

## KREU VII Mbyllja e Shoqerise

### *Neni 37*

Veprimtaria e shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne aktin e themelimit.

Veprimtaria e shoqerise mund te mbyllet edhe kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshem veprimtaria e shoqerise nuk rezulton rentabel, ose kur ortaku heq dore nga shoqeria.

### *Neni 38*

Kur shoqeria likuidohet asamblea mbledh komisionin e likuidimit i cili paraqet per miratim bilancin e likuidimit te shoqerise.

Shoqeria i jep fund veprimtarise ne çastin e miratimit te bilancit te likuidimit.

### *Neni 39*

Mjetet financiare si dhe çdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise kur shoqeria likuidohet, i takojne ortakut te vetem te saj, pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjithë kreditorët e shoqerise.

## KREU VIII DISPOZITA TE FUNDIT

### *Neni 40*

Te gjitha veprimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te veçante qe mbahet ne seline e shoqerise.

### *Neni 41*

Ky statut eshte hartua sot me daten 16/10/2021 per Shoqerine "Ndërtim-BS" Sh.p.k.

**ORTAKU I VETEM**

**Sabri IBRAHIMI**

*Sabri Ibrahim*  
